

Buletin informativ

Nr.2 – shkurt 2020



Ekspertët fiskal të Mazars në Shqipëri, kanë përgatitur një përmbledhje me risitë që sjell Ligji "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" (Ligji për Fiskalizimin) dhe hapat që duhet të ndiqen nga tatimpaguesit, për të qënë në përputhje me procesin e fiskalizimit.

Cfare është fiskalizimi?

"Fiskalizimi" nënkupton një sërë masash të zbatuara nga tatimpaguesit, që kanë detyrimin e lëshimit të faturave, për të mundësuar kontrollin efikas të qarkullimit, të realizuar me para në dorë apo në forma të pagesave pa para në dorë dhe kontrollin e lëvizjes së mallrave, nëpërmjet implementimit të një sistemi informatik qëndror, të monitoruar nga administrata tatimore.

Një prezantim skematik i procesit të fiskalizimit është paraqitur në fund të këtij buletini informativ.

Kush preket nga ky ligj?

- a) të gjithë tatimpaguesit që lëshojnë faturë sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar:
 - i. tatimpagues të tatimit mbi fitimin
 - ii. tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël
 - iii. organizatat jofitimprurëse, njësitë e zbatimit të projekteve, organet publike qendrore e vendore, organizatat politike dhe institucione të tjera të ngjashme
 - iv. tatimpagues jorezidentë, për furnizimin e shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet një përfaqësuesi tatimor.
- b) organet publike
- c) bankat, institucionet financiare jobankare dhe subjekte të tjera, që ofrojnë shërbime pagesash të faturave elektronike.

* Rregullat e aplikueshme për lëshimin e faturës janë në përputhje me legjislacionin aktual. Tatimpaguesi, sipas kategorisë ku bën pjesë mund të lëshojë:

- a) Faturë tatimore shitjeje
- b) Faturë të thjeshtë tatimore
- c) Faturë elektronike në përputhje me autorizimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve
- d) Faturë shoqëruese

Buletin informativ

Përrjashtohen nga detyrimi për tu shoqëruar me faturë tatimore kryeja e transaksioneve të mëposhtme (në përputhje me legjislacionin aktual):

- a) shërbimet e sigurimit, risigurimit dhe shërbimet e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime;
- b) dhënia dhe negocimi i kredive;
- c) negocimi ose çdo marrëveshje tjetër në garantimin e kredive;
- d) transaksionet, përfshirë negocimin lidhur me veprimet e këmbimit;
- e) transaksionet, përfshirë negocimin lidhur me valutën, kartëmonedhat apo monedhat e përdorura si mjete ligjore pagese;
- f) transaksionet, përfshirë negocimin, por jo menaxhimin apo ruajtjen, në aksione kuota, pjesë në shoqëri apo shoqata, në obligacione dhe tituj të tjerë;
- g) menaxhimi i fondeve të investimeve.

Cfarë duhet të bëjnë subjektet e prekura?

Te gjithë tatimpaguesit që kanë detyrimin për lëshimin e faturës duhet të pajisen me sistemin e fiskalizimit (software), që mundëson përdorimin e zgjidhjes software-ike të certifikuar. Lista e furnizuesve të zgjidhjeve softwerike do të publikohen në një moment të dytë.

Përvec sa më sipër, tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari ekonomike, në shitjen me pakicë, në ofrimin e shërbimeve në vende apo njësi të hapura për publikun apo çdo lloji veprimtarie tjetër të ngjashme me para në dorë, duhet të instalojnë edhe printerin, nëse nuk është pjesë integrale e pajisjes fiskale.

Procesi i fiskalizimit në një vështrim të përgjithshëm

Hapi I. Regjistrimi i tatimpaguesve në regjistrin e tatimpaguesve që lëshojnë fatura në përputhje me ligjin e fiskalizimit

- Tatimpaguesit, të cilët janë të regjistruar si tatimpagues aktiv në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, regjistrohen automatikisht në regjistrin e tatimpaguesve që lëshojnë fatura në përputhje me ligjin e fiskalizimit, që mbahet nga Administrata Tatimore Qëndrore.
- Tatimpaguesit e rinj, të cilët do të regjistrohen në regjistrin tregtar si dhe tatimpaguesit që kalojnë nga regjistri pasiv në regjistrin aktiv pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, regjistrohen automatikisht edhe në regjistrin në fjalë.

Hapi II. Regjistrimi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit dhe i pajisjeve elektronike të faturimit

Pas regjistrimit të tatimpaguesit në regjistrin e përmendur më sipër, ky i fundit detyrohet të dorëzojë nëpërmjet platformës qendrore të faturave dokumentacionin e mëposhtëm. Ky dokumentacion duhet dorëzuar jo më vonë se 24 orë përpara fillimit të lëshimit të faturës.

1. Të dhënat për vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, të specifikuar si më poshtë:

- numrin unik të identifikimit të tatimpaguesit që lëshon faturën;
- emrin tregtar të veprimtarisë së biznesit, nëse ka;
- adresën e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- llojin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- llojin e veprimtarive që ushtrojnë në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- orarin ditor të punës dhe ditët e punës gjatë javës, punën gjatë festave zyrtare;
- datën e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- datën e mbylljes së veprimtarisë në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, duke përfshirë datat e ndërprerjes së përkohshme, kur është rasti;
- sipërfaqen e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, kur kjo është e mundur;
- mënyrën e pagesës së pranuar për furnizimin e mallrave ose të shërbimeve në atë vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit (me para në dorë dhe/ose pa para në dorë);
- statusin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;

Buletin informativ

- emrin e ofruesit të lidhjes elektronike (internetit);
- shënimin nëse vendi i ushtrimit të veprimtarisë së biznesit është në pronësi ose me qira.

Pas dorëzimit të dokumentacionit të mësipërm, sistemi informatik i administratës tatimore gjeneron kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.

2. Të dhënat për çdo pajisje elektronike të faturimit

Tatimpaguesi dorëzon nëpërmjet platformës qendrore të dhënat për të gjitha pajisjet e faturimit elektronik. Brënda 24 orëve (që konsiderohet si periudha e testimit), sistemi informatik i administratës tatimore gjeneron kodin e pajisjes elektronike.

Kujdes: Të gjithë tatimpaguesit që janë pajisur dhe kanë instaluar pajisjet fiskale në fuqi përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë përdorimin e tyre edhe me sistemin e ri të fiskalizimit, duke shtuar një software që kryen ndërlidhjen e pajisje ekzistuese me sistemin.

Hapi III. Regjistrimi i operatorëve

Tatimpaguesi duhet të deklarojë të dhënat për çdo operator individual (me operator individual kuptohet individi që përpilon dhe lëshon faturat nëpërmjet sistemit fiskal), jo më vonë se 24 orë para fillimit të lëshimit të faturave nga secili operator. Të dhënat që kërkohen në këtë rast janë numri unik i identifikimit të tatimpaguesit dhe emri/mbiemri i operatorit.

Në rast se operatori është një shoqëri që ofron shërbime konsulence fiskale apo kontabiliteti (pra departamenti i financës është i outsource te palë të treta), tatimpaguesi përveç numrit të tij unik të identifikimit, dorëzon dhe numrin unik të identifikimit të shoqërisë që jep shërbimet në fjalë.

**Në përfundim të procesit të regjistrimit, tatimpaguesit do të pajisen me certifikatë elektronike, e cila gjenerohet nga AKSHI. Tarifat e certifikatës elektronike do të përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.*

Mënyra e lëshimit dhe e dërgimit të faturës

1. Fatura elektronike në rastin e pagesave me para në dorë

Rregullat e lëshimit të faturave për pagesat me para në dorë (rasti i transaksionit entitet-konsumator) janë në përputhje me legjislacionin aktual.

Ndryshimi i vetëm që parashikon legjislacioni i ri është fakti që para se fatura të printohet dhe dorëzohet te konsumatori, i është nënshtruar procesit të fiskalizimit dhe është pajisur me numrin identifikues të vecantë të faturës ("NIVF"), proces që kryhet nëpërmjet software të instaluar.

2. Fatura elektronike për pagesa pa para në dorë

Fatura për furnizimin e mallrave apo shërbimeve pa para në dorë (rasti i transaksionit entitet-entitet), lëshohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ndryshimi i vetëm i parashikuar nga ligji i fiskalizimit është fakti që fatura përpara se ti dorëzohet blersit, do ti nënshtrohet procesit të fiskalizimit. Më konkretisht, shitësi pasi përpilon faturën e shitjes, nëpërmjet software dhe lidhjes së internetit e dërgon atë pranë AKSHI. Pasi ky i fundit konfirmon rregullshmërinë e saj, lejon pajisjen me NIVF dhe e rikthen te shitësi, në mënyrë që ky i fundit të procedojë më procesin e lëshimit të faturës.

Në bazë të faturimeve të realizuara nga secili tatimpagues dhe të dhënave në regjistrin qendror të administratës tatimore, do të gjenerohen në mënyrë automatike librat e blerjes dhe të shitjes për secilin tatimpagues.

Cdo tatimpagues duhet të shqyrtojë librat e blerjes/shitjes brënda datës 10 të muajit pasardhës, dhe pas kësaj procedure konfirmon saktësinë e të dhënave dhe procedon më dërgimin e librave.

Buletin informativ

Procedura e fiskalizimit në vende pa mbulim interneti

Nëse tatimpaguesi, që lëshon faturë, ushtron veprimtarinë e vet tregtare në zona ku nuk është e mundur të vendoset lidhja elektronike (interneti), ai do të lëshojë faturën me përmbajtje sipas specifikimeve të ligjit për fiskalizimin, por është i përjashtuar nga përgjegësia e transmetimit të tyre të AKSHI.

Tatimpaguesi deklaron pamundësinë e lidhjes elektronike pranë administratës tatimore dhe kjo deklaratë verifikohet nga kjo e fundit bazuar në informacionin e marrë nga AKEP.

Gjithsesi këta tatimpagues duhet të pajisjen me zgjedhjen software të parashikuar në ligjin e fiskalizimit dhe duhet të dorëzojnë pranë administratës tatimore faturat mujore, në mënyrë që kjo e fundit ti pajisi manualisht me NIVF.

Hyrja në fuqi

Efektet e këtij ligji shtrihen në kohë sipas grafikut të mëposhtëm:


Lloji i transaksionet	Kategoria	Aplikueshmëria
Me para në dore	Subjektet me xhiro mbi 8 milionë lekë	1 shtator 2020
	Subjektet me xhiro nga 2 deri në 8 milionë lekë	1 janar 2021
	Subjektet me xhiro deri në 2 milionë lekë	1 janar 2021
Pa para në dore	Transaksionet ndërmjet subjekteve private dhe organeve publike	1 janar 2021
	Transaksionet ndërmjet subjekteve private	1 korrik 2021

Burimi: Fletorja Zyrtare Nr. 3, datë 20.01.2020, Ligji nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit".

Shënim: Ky buletin information ka për qëllim të paraqesi ndryshimet kryesore të sjella nga ligji i fiskalizimit, por detajimet përkatëse të zbatimit pritet të specifikohen nëpërmjet udhëzimeve të Ministrisë të Financave.

Buletin informativ

Skema 1. Procesi i fiskalizimit



KONTAKT

MAZARS ALBANIA & KOSOVO

Për më shumë detaje për çështjet e mësipërme apo të tjera në lëmin fiskal, ju lutem drejtohuni:

Teit GJINI

Managing Partner
teit.gjini@mazars.al

Erinda XHAFERRAJ

Head of Tax Advisory Services
erinda.xhaferraj@mazars.al

Adresa

Rr. Emin Duraku, Pall. Binjaket, Nr.5,
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2222 889
E-mail: info@mazars.al